



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ROSKOVEC  
KRYETARI

5077  
Nr. \_\_\_\_\_ prot

Roskovec ,më 19. 11 .2024

**NJOFTIM**

**“PËR SHPREHJE INTERESI PËR ANËTARSIMIN NË KËSHILLIN VENDOR  
RINOR(KVR)” ROSKOVEC**

Në mbështetje të pikes 3 të Ligjit nr.75/2019 “Për Rininë” nenit 54 të Ligjit Nr. 139/2019 “Për Vetqeverisjen Vendore” i ndyshuar, neni 54 gërma k,Ligjit Nr. 8548 datë 11.11.1999” Për ratifikimin e “Kartës Europiane të autonomisë vendore” Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore (SKBGJ) 2016-2020, Rezolutën CM/Res(2008) 23 mbi politikën rinore të Këshillit të Evropës,Bashkimit Evropian,Strategjia e Rinisë e BE-së(2019-2027), “ Forumi Evropian i Rinisë” një udhëzues për Standartet e Cilësisë së Politikave Rinore “ 2016, si dhe vendimin e Këshillit Bashkiak Roskovec nr.15 datë 28.02.2022, miratuar nga prefektura e qarkut Fier me shkresë nr. 244/1 datë 13.03.2022.

**Njoftojmë**

1.Të gjithë përfaqësuesit /anëtar të organizatave rinore nga mosha 15-29 vjeç të cilët kanë interes për t'u bërë pjesë e Këshillit Vendor Rinor dhe që përmbushin kriteret e mëposhtme :

- a) Të jetë anëtar I një organizate rinore ose për të rinjtë;
- b) të mos jetë I dënuar;
- c) të ketë përvojë në projekte ,nisma dhe veprimtari rinore dhe për të rinjtë;
- d) të mos ketë konflikt interesi për shkak të angazhimit të KVR-së;
  - Ftojme të rinjtë që duan të jenë pjesë e KVR-së, të paraqesin brenda datës 25. 11 2024 pranë zyrës së informacionit Bashkia Roskovec, dokumentacionet e mëposhtme:
    - a) Kërkesë me shkrim ku shpreh interes për aplikim;
    - b) jetëshkrim(CV)
    - c) fotokopje të dokumenteve që mbështesin shënimet e jetëshkrimit;
    - d) vërtetim të gjendjes gjyqësore ose vetëdeklarimin e saj;
    - e) referenca nga të paktën 2(dy) bashkëpunëtorë të mëparshëm;

f) letër interesi/motivimi

Shqyrtimi i aplikimeve dhe përzgjedhja e tyre do të bëhet brenda 10(dhjetë) ditëve kalenarike nga data e mbylljes së aplikimit.

*Duke ju falenderuar për bashkëpunimin dhe mirëkuptimin tuaj !*

**KRYETAR**  
**Majlinda Bufi**

